



Termet e Referencës për Konsulent

Ekspert Ligjor i Jashtëm për zhvillimin e një rasti studimor (case study)

Projekti: 2CRSVsurvivors: “Rrugët drejt fuqizimit: Promovimi i drejtësisë, shërimit dhe gjithëpërfshirjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin”

1. Konteksti:

Si pjesë e projektit 2CRSVsurvivors-“Rrugët drejt fuqizimit: Promovimi i drejtësisë, shërimit dhe gjithëpërfshirjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin”, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), synon të zhvillojë dhe publikojë një studim rasti që dokumenton sfidat ligjore dhe shoqërore me të cilat përballen të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në rrugën e tyre për drejtësi, shërim dhe gjithëpërfshirje.

QKRMT është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1999 që ofron shërbime ndërdisiplinore në mbështetje të viktimave civile të lidhura me konfliktin, veçanërisht të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë. Më tej, QKRMT-ja është e përfshirë në identifikimin, vlerësimin, trajtimin, referimin dhe monitorimin e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore në mesin e të riatdhesuarve dhe personave me shqetësim për UNHCR-në (të kthyerit, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat në rrezik të pashtetësisë).

Gjithashtu, në kuadër të mandatit të saj për të promovuar dhe avancuar respektimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT kryen vizita të rregullta monitoruese në vendet si: burgje, qendra të paraburgimit, qelitë e paraburgimit të policisë, institucionet e shëndetit mendor dhe gjithashtu promovon praktikën dhe standardet legjislative për mbrojtjen dhe ngritjen e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

QKRMT-ja e sheh rolin e saj në shoqëri si ofrues i shërbimeve, ndërgjyqëse dhe mbikëqyrës i të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë ka qenë përpjekja e vazhdueshme dhe e fuqishme avokuese që ka bërë QKRMT me institucionet qendrore dhe lokale në adresimin e nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale lidhur me konfliktin në Kosovë, si dhe personave të privuar nga liria.

Në kuadër të angazhimit tonë për avancimin e qasjes në drejtësi dhe promovimin e ndërgjegjësimin në aspektin ligjor për të mbijetuarit, QKRMT do të angazhojë një ekspert të jashtëm ligjor për të kontribuar në studimin e rastit duke analizuar pengesat ligjore me të cilat përballen të mbijetuarit, duke identifikuar boshllëqet në sistemin e drejtësisë dhe duke ofruar rekomandime konkrete për forcimin e qasjes së tyre në drejtësi.

2. Qëllimi i angazhimit

Angazhimi ka për qëllim zhvillimin e një analize të thelluar ligjore mbi sfidat me të cilat përballen të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin në qasjen e tyre në drejtësi, duke kombinuar analizën ligjore me gjetje nga dimensionet shoqërore.

Konsulenti do të udhëheqë procesin e hulumtimit dhe do të përgatisë një studim të plotë (case study) që identifikon pengesat ligjore, boshllëqet në zbatimin e ligjeve ekzistuese, praktikat gjyqësore dhe hapësirat për përmirësim institucional.

3. Fusha e punës:

Eksperti ligjor i jashtëm do të jetë përgjegjës për këto detyra:

- Shqyrtimi i kuadrit ligjor, politikave dhe praktikave gjyqësore të lidhura me të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin.
- Kontribut në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave (cilësore dhe sasiore) me fokus të veçantë në sfidat ligjore.
- Sigurimi i analizës ligjore të pengesave të identifikuara me të cilat përballen të mbijetuarit në qasje në drejtësi.
- Hartimi i pjesëve të studimit të rastit që lidhen me kuadrin ligjor, duke reflektuar edhe ndikimin e tyre psikosocial dhe social në jetën e të mbijetuarve.
- Verifikimi i gjetjeve përmes konsultimeve me palë kyçe, përfshirë praktikuesit ligjorë, institucionet dhe grupet e avokimit.

-Hartimin e rekomandimeve ligjore dhe avokuese që do t'i shërbejnë:

- hartuesve të politikave publike dhe institucioneve të drejtësisë,
- organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë përfaqësim ligjor dhe avokim,
- profesionistëve ligjorë të përfshirë në drejtësinë tranzicionale.

3. Materiali që duhet përfunduar:

- Plani dhe metodologjia e punës
- Raport paraprak me analizë fillestare të gjetjeve dhe boshllëqeve ligjore.
- Dokumenti përfundimtar: studim ligjor mbi sfidat e të mbijetuarve, që ndërthur perspektivën ligjore me aspektet sociale.

4. Afati kohor:

Angazhimi i ekspertit përfshin 10 ditë pune Brenda periudhës kohore nëntor/dhjetor 2025 duke filluar nga data 10 nëntor deri më 22 dhjetor 2025.

5. Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë universitare në Juridik, të Drejtat e Njeriut ose fusha të ngjashme.
- Ekspertizë e dëshmuar në fushën e të drejtave të njeriut, drejtësinë tranzicionale ose krimet e luftës.



- Së paku 5 vite përvojë profesionale në analizë ligjore, litigim ose punë praktike që lidhet me të mbijetuarit e dhunës seksuale.
- Njohuri të dëshmuara mbi dhunën seksuale në konflikt dhe qasje të orientuara te të mbijetuarit dhe të ndjeshme ndaj traumës.
- Aftësi të forta analitike, hartimi dhe komunikimi.
- Përvoja në kontributin në publikime kërkimore është një avantazh.

6. Raportimi:

Eksperti do t'i raportojë menaxherit të projektit të QKRMT-së dhe do të sigurojë përditësime të rregullta mbi progresin e konsulencës.

7. Buxheti:

Buxheti për këtë konsulencë do të mbulojë tarifat e ekspertit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me përfundimin e detyrave të përcaktuara në fushën e punës, sipas planit të punës dhe kontratës së dakorduar.

8. Procesi i aplikimit:

Ekspertët e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në e tyre, Letër reference dhe një propozim të shkurtër që përshkruan qasjen e tyre ndaj konsulencës, në QKRMT në info@krct.org, duke shënuar në titull të emailit “Ekspert ligjor i jashtëm”, deri më 22 tetor 2025.

Shënim: QKRMT rezervon të drejtën të refuzojë një ose të gjitha propozimet e pranuar, dhe do të kontaktojë vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.